

PLUS COMMUNICATION SH.A.

Selia Ligjore: Rr. "Ibrahim Rugova", Godina e Re pranë Gardës së Republikës, Kat 2, Tiranë
Kapitali Themeltar: 266.430.050,00 ALL
NUIS: K91811014B

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
PLUS COMMUNICATION SH.A.

Sot, më datë 18 Shtator 2017, në orën 17:00, pranë selisë ligjore të Shoqërisë Plus Communication Sh.A., në Rr. Ibrahim Rugova, Godina e Re pranë Gardës së Republikës, kat 2, Tiranë, Shqipëri (këtë e tutje "Shoqëria" ose "Plus"), u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Janë të pranishëm:

1. **Albanian Distribution & Development Sh.p.k.**, me seli ligjore në Rruga Dhaskal Tod'hri, nr. 35. Kashar, Tiranë, NUIS K21308001C, përfaqësuar nga administratori Z. Xhafer Xhako, shtetas shqiptar, lindur në Kolonjë, më 1 Janar 1964, me vendbanim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 12,13% të kapitalit të Shoqërisë;
2. **Alba – Trade Handels GmbH**, me seli ligjore në Schwarzenbegstraße 1-3, 1010 Vjenë (Austri), e përfaqësuar nga përfaqësuesi me autorizim Z. Kreshnik Dibra, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 22 prill 1982, me vendbanim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 31,83% të kapitalit të Shoqërisë;
3. **UNION Grup Sh.p.k.**, me seli ligjore në Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Ismail Qemali, nr. 32, kat 3, 1019, Tiranë, NUIS K61527801R, e përfaqësuar nga administratori Z. Edmond Leka, shtetas shqiptar, lindur më 17.05.1963, në Tiranë, me vendbanim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 19,99% të kapitalit të Shoqërisë;
4. **Znj. Vjollca Hoxha**, shtetase shqiptare, lindur më 23.03.1969, në Tiranë, me vendbanim në Tiranë, përfaqësuar nga përfaqësuesi me prokurë Znj. Xhejsila Hako, shtetase shqiptare, lindur më 20.05.1986, në Tiranë, me banim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 12,43% të kapitalit të Shoqërisë;
5. **Z. Armand Duka**, shtetas shqiptar, lindur më 07.10.1962, në Shijak, me vendbanim në Durrës, përfaqësuar nga përfaqësuesi me prokurë Z. Erion Hoxhaj, shtetas shqiptar, lindur më 06.08.1980, në Tiranë, me vendbanim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 1,86% të kapitalit të Shoqërisë;
6. **Z. Edevaldo Haxhiu**, shtetas shqiptar, lindur në Shijak - Durrës, më 28.04.1985, me vendbanim Shijak, përfaqësuar nga përfaqësuesi me prokurë Z. Erion Hoxhaj, shtetas shqiptar, lindur më 06.08.1980, në Tiranë, me vendbanim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 0,26% të kapitalit të Shoqërisë;
7. **Postë Telekomunikacioni i Kosovës**, me seli ligjore në Prishtinë, Kosovë, Dardania nr. 10.000, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Z. Arian Gashi, shtetas kosovar, lindur më 16.04.1976, në Mitrovicë, me vendbanim në Kosovë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 0,11% të kapitalit të Shoqërisë;
8. **Znj. Matilda Shehu**, shtetase shqiptare, lindur në Korçë, më 27 prill 1973, me vendbanim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 0,41% të kapitalit të Shoqërisë;
9. **Znj. Gentiana Gjermenit**, shtetase shqiptar, lindur në Fier, më 2 maj 1975, me vendbanim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 0,01% të kapitalit të Shoqërisë.

Lista e aksionarëve të pranishëm në Asamblenë e Përgjithshme i bashkëlidhet këtij procesverbalii si shtojca A.

Me konsensusin e të pranishmëve, Z. Kreshnik Dibra merr përsipër drejtimin e mbledhjes si kryetar i saj dhe fton Z. Enklid Milaj, që është gjithashtu i pranishëm dhe pranon, të kryejë funksionin e Sekretarit. Kryetari deklaron se Asambleja e Shoqërisë është mbledhur në thirrjen e dytë të saj, në përputhje me statutin, në vijim të thirrjes datë 21 gusht 2017 drejtuar aksionarëve të Shoqërisë për të diskutuar dhe vendosur mbi Rendin e Ditës si më poshtë vijon.

K.D

PLUS COMMUNICATION SH.A.

Selia Ligjore: Rr. "Ibrahim Rugova", Godina e Re pranë Gardës së Republikës, Katër 2, Tiranë
Kapitali Themeltar: 266.430.050,00 ALL
NUIS: K91811014B

Rendi i ditës

1. Çështje të rregullimit të tregut dhe propozim për zgjidhje;
2. Statusi i transaksionit me Hightel Towers Albania Sh.a.;
3. Të tjera.

Pasi konstaton

praninë e aksionarëve që përfaqësojnë 79,03% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, të paraqitur personalisht ose nëpërmjet prokurave të posaçme, Kryetari

deklaron

mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (këtë e tutje "Asambleja") të rregullt dhe të aftë për të diskutuar e vendosur në mënyrë të vlefshme mbi Rendin e Ditës në përputhje me nenin 12 të Statutit të Shoqërisë.

1. Çështje të rregullimit të tregut dhe propozim për zgjidhje

OMISSIS

"M. Shqipëria ne te"

PLUS COMMUNICATION SH.A.

Selia Ligjore: Rr. "Ibrahim Rugova", Godina e Re pranë Gardës së Republikës, Kat 2, Tiranë
Kapitali Themeltar: 266.430.050,00 ALL
NNIC: KG4844044D

2. Statusi i transaksionit me Hightel Towers Albania Sh.a.

Ne lidhje me piken e dyte te rendit te dites, Kryetari fton Administratorin te perditesoje Asamblene e aksionereve ne lidhje me marredheniet me grupin Hightel Towers Italy pjese e te cilit eshte edhe Hightel Towers Albania sh.a.

Znj. Matilda Shehu i shpjegon te pranishmeve se, ne baze te marreveshjeve te lidhura, shkaku dhe fryma e marreveshjes me Hightel Towers bazohej ne faktin se ky i fundit do t'a jepte me qera kullat Plus per nje periudhe shumevjecare. Nese Plus mbyll transaksionin me operatoret sa me siper nuk ka mundesi te verifikohet.

Aktualisht Plus ka te drejte te marre mbrapsht 75% te kuotave te Plus Network sh.p.k.. Por, ne baze te disa hulumtimeve te kryera ne treg dhe vleresimeve te brendshme nga ana e Shoqerise, rezulton se asetat qe ka Plus Network sh.p.k. nuk mund te gjejne lehtesish bleres te mundshem dhe cmontimi i tyre dhe shitja per skrap do te ishte nje kosto tjeter per Plus. Nderkohe Plus ka per detyrim kundrejt plus Network sh.p.k. te kontrolluar teresisht nga Hightel te paguaje qerane te cilin nuk e ka permbushur.

Gjithashtu shton Znj. Matilda Shehu, nese transaksioni me operatoret i pershkruar ne piken e pare te rendit te dites ecen perpara, Hightel Towers s.p.a. (shoqeria meme e se drejtes italiane) ka te drejte te kerkoste te gjithe investimin qe ka bere ne shumen prej 2,400,000 Euro + 15% interes vjetor te cilat aktualisht illogariten rreth 200,000 Euro. Ne fakt, duke qene se Hightel Towers eshte ne dijeni te bisedimeve per shkak te informacioneve qe i jane dhene nga operatoret e trete, Hightel Towers eshte duke kercenuar per zgjidhje gjyqesore duke aluduar, nder te tjera, per vonesa te qellimshme per te penguar procesin e reimbursimit.

Ne kete pike, ne vijim te vendimit te Asamblese se Pergjithshme te dates 10 maj 2017 dhe duke marre parasysh sa me siper, kane vazhduar negociatat me Hightel Towers dhe eshte dakortesuar nje marreveshje e mundshme qe reflekton sa me poshte: (i) Plus te heq dore nga arketimi i vleres se mbetur te pashlyer prej 8,800,000 Euro, (ii) Plus te heq dore nga opzioni call mbi 75% te kuotave te Plus Network sh.p.k., (iii) Hightel dhe Plus te heqin dore nga cfareolloj padie ne lidhje me marredhenien e tyre dhe, ne kete menyre, Hightel Italia heq dore nga pretendimi per te perfituar 2,400,000 Euro plus interesa, (iv) Plus ne shkembim t'i paguaje Hightel Albania shumen prej 1,100,000 Euro (v) Plus te transferoj tek Plus Network sh.p.k. dy kullat e mbetura (Misto Mame Hil dhe Ligovun)

PLUS COMMUNICATION SH.A.

Selia Ligjore: Rr. "Ibrahim Rugova", Godina e Re pranë Gardës së Republikës, Kati 2, Tiranë
Kapitali Themeltar: 266.430.050,00 ALL
NUIS: K91811014B

si dhe disa asete per një vlerë jo me te larte se 400,000 Euro me TVSH (ku perfshihen 59 gjeneratore, 53 shelter, MW (aviation light), (vi) Hightel mos te kerkonte pagimin e detyrimit te qerase per 2017 dhe te lejoje Plus te qendroje pa qera per 3 (tre) vjet dhe (vii) duke filluar nga data efektive e marreveshjes Hightel te marre persiper, direkt ose indirekt, te paguaje qerate e tokave mbi te cilat jane vendosur kullat pavaresisht se nuk ka perfunduar ende procesi i cedimit te kontratake te qerase tek Hightel.

Pas një diskutimi te shkurter mbi këtë çështje, Asambleja unanimisht

VENDOS

- të miratojë nenshkrimin e marreveshjes me Hightel Towers Albania sh.p.k. duke perfshire si pale te saj edhe Hightel Towers S.p.A. sipas kushteve dhe afateve te pershkruara me siper duke autorizuar Keshillin e Administrimit te marre te gjitha masat e nevojshme per te autorizuar Administratoren e Shoqerise, Znj. Matilda Shehu per lidhjen e kontrates perkatese. Ky vendim hyn ne fuqi duke filluar nga momenti ne te cilin eshte bere efektiv transaksi me operatoret i pershkruar ne pikën e pare te rendit te dites.

3. Të tjera

Në lidhje me pikën e tretë të Rendit të Ditës, Kryetari vë në dukje se në vijim të vendimit të Asamblesë të datës 19 korrik 2017 përmiratimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2016, Asambleja duhet të vendosë në lidhje me destinimin e fitimit të vitit 2016.

Kryetari ja jep fjalën Administratorit të Shoqërisë, Znj. Matilda Shehu, e cila evidenton faktin se për vitin ushtrimor 2016, Shoqëria ka realizuar një fitim prej 947.225.086 Lekë dhe rrjedhimisht, në përpunje me statutin e Shoqërisë propozon destinimin e tij për të mbuluar humbjet e periudhave të mëparshme.

Pas një vlerësimi të matur e diskutimi mbi këtë çështje, Asambleja unanimisht

VENDOS

- të destinojë fitimin që rezultoi nga pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2016 të cilat u miratuan nga Asambleja e Shoqërisë më 19 korrik 2017 për të mbuluar humbjet e periudhave të mëparshme ushtrimore.

Duke qenë se nuk ka çështje të tjera për të diskutuar dhe duke qenë se askush nuk e kërkoi fjalën, Kryetari e deklaron mbledhjen të mbyllur në orën 19:00.

Dokumentet në vijim i bashkëlidhen këtij vendimi:

- Listë-prezenca e aksionarëve të pranishëm në Asamble;
- Prokurat e aksionarëve të përfaqësuar në Asamble.

Kreshnik Dibra

Kryetari/ Kreshnik Dibra

[Handwritten signature]



Elli Milaj

Sekretari/ Enklid Milaj

[Handwritten signature]